

VENDIM
Nr. 859, datë 30.9.2013

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 679, DATË 16.8.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I
JEPET SHOQËRISË, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “GAFER””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr. 679, datë 16.8.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Gafer””.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama